



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Referenca: 626-19-029-5-2-1

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të Sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë;

Dhe

Grupi i Operatorëve Ekonomik "NBT-ING" SH.P.K. me nr. të biznesit: 70477229 me seli në Suharekë dhe "EKO GROUP" SH.P.K. me numër të biznesit: 810872582, selia në Prishtinë të cilët me autorizim i përfaqëson z. Bexhet Baftjaraj, në cilësinë e bashkëpronarit të NBT-ING SH.P.K. (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë si më poshtë:

Titulli i Kontratës: NDËRTIMI I SHESHIT NË KOMUNËN E MAMUSHËS - FAZA E PARË

me numër identifikues: 626-19-5590-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate ka të bëjë me ndërtimin e sheshit në Komunën e Mamushës e cila ka të bëjë me kryerjen e punëve përcjellse për rrugë dhe trotuar, ndërtimi i kanalizimit atmosferik, kanal rezerv dhe ndriqim publik si dhe punët tjera të parapara në projektin ekzekutiv dhe paramasën e bashkangjitur si më poshtë:

NDERTIMI I "SHESHIT" NË KOMUNËN E MAMUSHËS - FAZA E PARË			
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia
1.00	RRUGA DHE TROTUARËT		
1.1	PUNËT PARAPRAKE		
1.1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtës për punë si dhe largimi i instalimeve në punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	707.00
1.1.2	Shenimi i trasesë si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m'	707.00
1.1.3	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve.	m'	707.00
1.1.4	Prerja dhe demolimi i dy shtresave të asfaltit në hyrje dhe dalje të sheshit, si dhe transporti i tyre deri në deponim të cilën cilën e cakton organi mbikqyrës, jo më largë se 5 km.	m ²	250.00
1.1.5	Demontimi i kubzave egzistuese me shtresat zhavorike në tërë sipërfaqen e rrugës dhe trotuareve të sheshit, si dhe transporti i tyre deri në deponim të cilën cilën e cakton organi mbikqyrës, jo më largë se 5	m ²	2,660.00

	km.		
1.1.6	Demontimi I skajorve egzistuese përgjatë rrugës dhe trotuareve të sheshit, si dhe transporti I tyre deri në deponim të cilën cilën e cakton organi mbikqyrës, jo më largë se 5 km.	m'	1,100.00
1.2	PUNIMET E DHEUT		
1.2.1	Gërmimi i humusit t=20 cm, me ngarkim dhe bartje deri në deponim jashte trupit te rruges	m ³	764.00
1.2.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së (III-IV) me makeneri, me ngarkim dhe bartje deri në deponi (deri në 5Km), duke llogaritur edhe kanalet ansore. Sasia të llogaritet në m ³ .	m ³	1,477.00
1.2.4	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri $M_v \geq 45 \text{ MN/m}^2$.	m ²	2,210.00
1.2.5	Punimi i bankinave me trashësi t=25cm dhe gjerësi 0.50m me materiali zhavorik frak.(0-32)mm.	m ³	85.00
1.3	MBISTRUKTURA		
1.3.1	Furnizimi, punimi i shtreses stabilizuese me materjal jokohorent të granuluar (80MN/m ²) të trupit të rrugës 0-100mm me trashësi t=30cm me CBR>15%	m ³	798.00
1.3.2	Furnizimi, bartja dhe shtrirja e gjeotekstitit tipi TYPAR SF 49 nën shirita qarkullues(300gr/m ²)	m ²	2,660.00
	Furnizimi, bartja dhe shtrirja e zhavorit te lumit t=5cm për mbrojtjen e gjeotekstitit.	m ²	133.00
1.3.2	Furnizimi, punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=25cm dhe ngjeshja me cilindër sipas stanadarteve dhe rregullave teknike.	m ³	665.00
1.3.3	Furnizimi dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=15cm dhe ngjeshja me cilindër sipas stanadarteve dhe rregullave teknike	m ³	399.00
1.3.5	Furnizimi me material anesore te gurit me dimensione 15x25x50cm të vendosur në shtresen e betonit ne trashësi 15cm, për kufizimin e trotuarëve, ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimi EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i ansoreve te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rruges kaluese ekzistuese . Per te gene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga llaqi i qimentos. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori.	m'	550.00
1.3.6	Furnizimi me material anesore te gurit me dimensione 10x20x50cm të vendosur në shtresen e betonit ne trashësi 15cm, për kufizimin e trotuarëve, ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimi EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i ansoreve te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rruges kaluese ekzistuese . Per te	m'	550.00

	gene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga llaqi i qimentos. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori.		
1.3.8	Furnizimi me material pllaka te gurit me siperfaqe te gravuar (gerrvishja e siperfaqes duhet te perputhet me planet inxhinierike dhe mostren e punuar) me dimensione 30x20x10cm ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimi EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i pllakave te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rrugeve kaluese ekzistuese . Per te qene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga (50-80) mm me zhavor adekuat. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori, ku do te perdoren 2 nuanca. Guret duhet te vendosen në shtrese betoni të klasit C-25/30, me trashsi t=15cm te armuar me rrjete Ø 8 mm 15 x 15 cm.	m ²	2,310.00
1.3.9	Furnizimi me material pllaka te gurit te ngritur tek siperfaqet e rrethit me siperfaqe te gravuar (gerrvishja e siperfaqes duhet te perputhet me planet inxhinierike dhe mostren e punuar) me dimensione 30x20x10cm ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimi EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i pllakave te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rrugeve kaluese ekzistuese . Per te qene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga (50-80) mm me zhavor adekuat. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori, ku do te perdoren 2 nuanca. Guret duhet te vendosen në shtrese betoni të klasit C-25/30, me trashsi t=15cm te armuar me rrjete Ø 8 mm 15 x 15 cm.(Ky pzcion do te realizohet ne siperfaqet hyrese tek rrethi per ngadalesim te shpejtesise-police i shtrire)	m ²	350.00
1.3.9	Ngritja dhe nivelizimi i pusetave të kanalizimit ekzistues deri në nivelin e gureve si dhe furnizimi me kapak kompozit 40t dhe montimi i tyre në bazament betoni.	copë	13.00
1.3.10	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtes nga materialet ndertimore.	m'	390.00
1.4	PUNËT E BETONIT		
1.4.1	Punët montuese		
4.1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave betonarme Ø400mm me mufa për leshesën gypore si ne projekt duke llogaritur edhe betonin e kokave hyrse dhe dalse, përfshir edhe punët e gërmimit, zhavorit, me të gjitha pozicionet e nevojshme për ekzekutim të punimeve.	m'	4.0
2	NDËRTIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK		
2.1	Punët përgaditore		

2.1.1	Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i përkohshëm i tyre	m'	395.0
2.1.2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë rrjeti i kanalizimit atmosferik si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik	m'	395.0
2.2	Punët Demoluese		
2.2.1	Demolimi i gypave të Kanalizimit ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	m'	395.0
2.3	Punët tokësore		
2.3.1	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe kolektorët e grilave në kat. III-IV të dheut, më makinë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilit gjatësor.	m ³	479.0
2.3.2	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe kolektorët e grilave në kat. III-IV të dheut, më dorë, në zgjerimet për puseta si dhe vendet ku nuk mund të punohet më makinë. Gjërësia e kanalit sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilit gjatësor.	m ³	47.9
2.3.3	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, sipas detalit në projekt, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet për thellësitë dhe kategorinë e tokës që janë të parapara më masat e mbrojtjes në punë. Sasitë janë indikative dhe punëkryesi në bashkëpunim më organin mbikqyrës vendos se ku do të aplikohen këto masa. Rrjedhimisht të dy mbajnë përgjegjësinë për këtë proces	m ²	290.0
2.3.4	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ± 1 cm.	m ²	300.0
2.3.5	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar (tepërt) deri në deponi të qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi maksimale deri në 10 km.	m ³	526.9
2.3.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16 mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa	m ³	139.2
2.3.7	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 16-31.5 mm për mbushjen e kanalit nga pjesa e sipërme e gypit deri në nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m ³	286.0
2.3.8	Largimi i ujërave nëntokësore me pompa. Ky pozicion është indikativ dhe është paraparë për rastin e paraqiten se ujit në kanal gjatë egzekutimit.	orë	10.0
2.4	Punët montuese		
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN4 për kolektorin kryesor.		

2.4.1	Ø315		m'	210.0
2.4.2	Ø250		m'	80.0
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN4 për kolektorët e grilave për ujmbledhsat.			
2.4.3	PESN8 Ø 200 mm		m'	56.0
2.5	Punët e betonit dhe armaturës			
2.5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta, me betonarme C- 20/25 d=20cm		m ³	4.5
2.5.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.me betonarme C- 20/25.		m ³	3.2
2.5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).		copë	10.0
2.5.4	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).		copë	10.0
2.5.5	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave prej betonit të armuar Ø400/1000mm për pusetat e ujëmbledhësve.(elemente të parafabrikuara).		copë	10.0
2.5.6	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.		copë	56.0
2.5.7	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.		copë	8.0
2.5.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësa (prej gize), Në çmim të llogarohet betoni i kurores sipas detalit të dhëne prej beton armesë C-20/25.		copë	8.0
2.6	Punët tjera			
2.6.1	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtes		m	290.0
2.6.2	Testimi i rrjetës së kanalizimit atmosferik.		m'	290.0
2.6.3	Matjet gjeodezike dhe përpilimi i dokumentacionit teknik të punëve për punët e zbatuara si dhe dorëzimi teknik i projektit		m'	290.0
3	KANALI REZERVË			
	Përshkrimi i punimeve dhe i materialit për furnizim		Njësia	Sasia
3.1	Hapja e kanalit me dim. 60x180cm, për shtrirjen e gypave PE të brinjëzuar, ngjeshja, mbulimi i kanalit pas shtrirjes së gypave dhe rërës si dhe largimi i dheut të tepërt		m ³	421.2
3.2	Hapja e pusetës me dimensione 200x200x200cm dhe largimi i dheut të tepërt		m ³	112.5
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rërës së imët me trashësi 20cm nën dhe mbi gypat PVC		m ³	140.40
3.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave PE të brinjëzuar SN4,		m	

	Ø160mm (4x Ø160mm)		1,560.0
3.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e mbrojtëses mekanike të kabllave tip GAL, dhe i shiritit paralajmërues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit	m'	390.0
3.6	Furnizimi, transporti dhe shenjëzimi i pusetave me shenja të mesingut për tension	Copë	15.0
3.7	Furnizimi, transporti dhe punimi i pusetave me dimensione 200x200x200cm, nga betoni i armuar i lyer me material hidroizolues, kapaku i së cilës është metalik me formë katrore prej materialit të derdhur me dimensione 65x65cm, që do të jetë për nevoja të shpërndarjes së kabllave të tensionit të lartë, dhe kabllave të ndryshme.	Copë	16.0
4	NDRIQIMI PUBLIK		
	Përshkrimi i punimeve dhe i materialit për furnizim	Njësia	Sasia
4.1	Mihja dhe mbulimi i kanalit për shtrirjen e gypit dhe kabllit furnizues për ndriqim 800x40cm (800m).	m ³	124.8
4.2	Mihja e dheut për bazament të shtyllave me dimensione 70x70x80 cm	copë	18
4.3	Furnizimi transporti dhe vendosja e shiritit për tokezim Fe/Zn 25x4 mm.	m	390
4.4	Furnizimi transporti betonimi i bazamentit të shtyllave 70x70x80 cm me beton të tipit MB30, si dhe vendosja e gypit HDPE SN8Ø200mm për ankerim të trupit ndriques.	copë	18
4.5	Porosia dhe vendosja e gypit të brinjëzuar PVC Ø63 për kabllon furnizues të trupave.	m	390
4.6	Furnizimi transporti vendosja e shiritit mbrojtës të tipit GAL.	m	390
4.7	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues.	m	390
4.8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gyp.	m ³	62.4
4.9	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 16-32 mm për mbushjen e kanalit nga pjesa e sipërme e gypit deri në nivelin e konstruksionit të trotuarit. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m ³	62.4
4.10	Furnizimi transporti dhe montimi i njehsorit elektrik të tipit 3x380/220V,5A,50Hz.	copë	1
4.11	Furnizimi transporti dhe montimi i Ormanit shpërndarës me dimensione 1000x950x400 mm IP 40 i kompletuar.	copë	1
4.12	Furnizimi transporti dhe montimi shtyllave metalike dekorative të galvanizuara të ndriqimit, me lartësi 8.0m, me dërra për hapje, formë konike me lira një krihshe dhe trashësi të mureve dhe pamje të dhëna si në pjesën grafike. Modeli i shtyllave dekorative është paraqitur në pjesën grafike të projektit, ose në konsultim me organin mbikqyres përcaktohet modeli i shtyllës.	copë	18
4.13	Furnizimi transporti dhe montimi shtyllave metalike dekorative me lartësi 8.0m të galvanizuara, që do të vendosen në dy rrethrotullimet, me dërra për hapje, formë konike me lira katër krihshe dhe trashësi të	copë	1

	mureve dhe pamje te dhene si ne pjesen grafike. Modeli i shtyllave dekorative eshte paraqitur ne pjeswn grafike te projektit, ose ne konsultim me organin mbikqyres percaktohet modeli i shtylles.		
4.14	Furnizimi dhe montimi i armaturave ndriçuese të teknologjisë LED.Ndriçuesi LED duhet ti përmbajë këto karakteristika: 1 LED ndriçues me shpërndarje asimetrike të dritës me drajver të programuar, me mundësi të zvogëlimit të intensitetit të dritës deri në 50% 2 Mbajtja e fluksit të dritës minimalisht L80B10 te 50000 orë pune 3 Rezistenca ndaj goditjeve IK10 sipas HRN EN 62262 4 Efikasiteti i ndriçuesit >122 lm/W 5 ULOR=0% 6 Mbrojtja e tërë ndriçuesit në IP66 sipas EN 60598 7 Garancioni pesë vjeçar i prodhuesit për tërë ndriçuesin që duhet të vëtetohet me dokumentacionin përkatës 8 Faktori CRI>80; 4000K 9 Fuqia e ndriçuesit 98ë-118ë dhe me fluks të dritës prej 11 956 lm deri në 14396lm 10 Trupi i ndriçuesit duhet të jetë nga alumini 11 LED ÇIPI: Cree,XTE 12 Numri i LED moduleve: 5-6 13 Numri i çipave(qelulave) për modul: 12 copë 14 Ndriçuesi duhet të jetë i çertifikuar nga: CE,ENEC,IDA dhe ISO(ISO 9001:2008 dhe ISO 14001:2004) Armaturat ndiçuese LED duhet të jenë të prodhuesve kualitativ.	copë	22
4.15	Furnizimi transporti dhe montimi bazes se aralditit per lidhje dhe vazhdim te kabllor furnizuese te ndriqimit NYM 3x1.5 mm2, per shtylle.	copë	18
4.16	Furnizimi transporti dhe montimi i kabllor per furnizim te poqit ndriques nga baza e aralditit PPY 3X1.5 mm2.	m	390
4.17	Furnizimi transporti dhe vendosja e kabllor furnizuese të tipit NYJ-J(Cu) 4x25mm ²	m	50
4.18	Furnizimi transporti montimi I nderpreresve AS-160A Shneider.	copë	1
4.19	Furnizimi transporti montimi I nderpreresve gungor 100A Shneider.	copë	1
4.2	Furnizimi transporti dhe montimi i transformatorit rrymor 100/5A.	copë	1
4.21	Furnizimi transporti montimi I mikronderpreres 6A.	cope	1
4.22	Furnizimi transporti montimi I portllampë me bazë E27.	copë	1
4.23	Furnizimi transporti montimi I prizës OG 10A.	copë	1
4.24	Furnizimi transporti montimi I pajisjet për matje-Votmetër 0-500V.	copë	1
4.25	Furnizimi transporti montimi I ndërprerës të tipit GS-16-66U.	copë	1
4.26	Furnizimi transporti montimi I siguresa trepolare gjysmeautomatike 63A.	cope	4
4.27	Furnizimi transporti montimi I sigureses njepolare 10A.	copë	3
4.28	Furnizimi transporti montimi I instrument për matje-Ampermetër 0-	copë	1

	200A.		
4.29	Furnizimi transporti montimi I nderpreresit zgjedhes per ampermeter 80A-u-R10	copë	1
4.3	Furnizimi transporti montimi I përçuesit PF 1x25mm ² .	m	70
4.31	Furnizimi transporti montimi I përçuesit PF 1x2,5mm ² .	m	70
4.32	Furnizimi transporti montimi I i kontaktorëve të tipit CS 100-160A.	copë	1
4.33	Furnizimi transporti montimi I i fotorelesë .	copë	1
4.34	Porositja dhe realizimi I atesteteve te tokezimit dhe te izolimit te kablllove	copë	1
4.35	Furnizimi transporti dhe shenjezimi i trases me shenja	copë	14
4.36	Realizimi I inqizimit te terenit	m	390
4.37	Pastrimi i terenit	m	390

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **199.120,71 €**;

Njëqindenëntëdhjetëenëntmijë e njëqindë e njëzetë Euro e shtatëdhjetë e një Eurocent.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) **Procesverbali i mbledhjes informative në mes të Punëkryesit, organit mbikëqyrës dhe menaxherit të kontratës i cili do të mbahet para nënshkrimit të planit të menaxhimit të kontratës me datë: 02.10.2019 ora 10:00.**

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për

Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Gazmend Gashi	Emri:	Bexhet Baftjaraj
Pozita:	<i>Udhëheqës i sektorit të Prokurimit</i>	Pozita:	<i>Bashkëpronar</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.10.2019	Data:	01.10.2019
Vula:		Vula:	

**1. PJESA II E KONTRATES
PËRGJITHSHME**

KUSHTET E

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **"Punë"** konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 **"Kontraktuesi"** është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 **"Menaxheri i Projektit"** është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 **"Çmimi Kontratës"** do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 **"Vendi i ndërtimit"** do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 **"Pajisjet e kontraktuesit"** do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 **"Skicat"** nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 “KPK” do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj të një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhën ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkritazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Obligimet e Autoritetit Kontraktues

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim të mirë nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbajë çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthejë ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndhimja lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

Obligimet e Kontraktuesit

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësinë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të **Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm**.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend-punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen në kryerjen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjë nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca më e madhe të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

Materialet dhe mjeshtrëritë

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;
- b) deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune në progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikut materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuase të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do të lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtrëritë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtrëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do të miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigjojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.

- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe /ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimin përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **“Force Madhore”** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vendpunimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES -KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Kushtet dhe detyrimet
Kushtet e Veçanta të Kontratës	1.	<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i> <i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese.</i>
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.1	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha: Shqipe.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	3.	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Përgjegjësia e kontraktuesit është në rast të shkakimit të dëmeve në persona, staf apo objekte përreth.
Programi	4.	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	4.1	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj kontrate.

Inspektimi dhe testimi	5.	Menaxheri i Projektit dhe organi mbikëqyrës: Menaxheri i projektit është caktuar nga ana e kryetarit të Komunës me vendimin nr. 02 Nr.08-18, të datës 17/01/2018. Mbikëqyrjen do ta bëjë Operatori Ekonomik “TRIANGLE” SH.P.K. në bazë të kontratës për mbikëqyrje
Fillimi i punëve	6.	Data e fillimit të punimeve sipas planit dinamik të kontraktuesit do të jetë me: 04.10.2019
Përfundimi i punëve	6.1	Punët do të ekzekutohen në bazë të planit dinamik të cilin e ka paraqitur kontraktuesi në tenderin e tij. Ditët e punës do të llogariten sipas regjistrimit në ditarin e punës.
Përmirësimi i defekteve	7.	Periodha për përmirësimin e defekteve është 5 ditë pas dorëzimit të kërkesës (Vërejtjes) nga ana e Organit Mbikëqyrës të kontratës.
Fillimi i realizimit të punëve (dorëzimi i vend punishtes)	8.	Data e posedimit të vend punimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të planit për menaxhimin e kontratës. Plani i menaxhimit të kontratës do të behet brenda 2 ditëve pas nënshkrimit të kontratës.
Dëmet e likuiduara	9.	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë [0,05%] në ditë, ose [5/100] të vlerës së punëve të pa dorëzuara/realizuar për një ditë vonese. Autoriteti Kontraktues mund t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me deri në një maksimum prej [10 %] të vlerës totale të kontratës. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Garacioni i kualitetit të punëve	10.	Garacioni i kualitetit të punëve do të jetë 24 muaj. Pas përfundimit të punimeve para pagesës së fundit kontraktuesi duhet të sjellë garancionin për kualitet të punimeve në vlerë 10% të shumës së përgjithshme të kontratës të vlefshëm për 13 muaj.
Parapagimi	11.	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	12.	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Pagesa e mjeteve	13.	Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate me të cilën vërteton pjesën e përfunduar të punëve të ekzekutuar sipas kontratës.
Siguria e ekzekutimit	14.	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës totale të kontratës, kontraktuesi do ta dorëzojë sigurinë e ekzekutimit para nënshkrimit të kësaj kontrate për kohëzgjatjen e periudhës prej 90 ditë.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	15.	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja të cilën e nxjerrë Organi Mbikëqyrës në bashkëpunim me menaxherin e projektit pas kontrollimit dhe vlerësimit të punëve të mbetura pa u përfunduar sipas kësaj kontrate dhe specifikimeve teknike në dosje të tenderit.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	16.	Palët do të tentojnë që ti zgjidhin mosmarrëveshjet në mënyrë miqësore. Sapo te shfaqet ndonjë mosmarrëveshje palët do ta njoftojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e mosmarrëveshjes dhe do ti sugjerojnë palës tjetër mbi variantin e zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshje.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	17.	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje Ekonomike në pajtim me ligjin në Kosovë.

PËRSHKRIMI I ÇMIMIT

Titulli i Tenderit: "NDERTIMI I "SHESHIT" NË KOMUNËN E MAMUSHËS - FAZA E PARË"

Nr i prokurimit	626-19-5590-5-2-1
Nr i brendshëm	626-19-029-5-2-1


NDERTIMI I "SHESHIT" NË KOMUNËN E MAMUSHËS - FAZA E PARË					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	RRUGA DHE TROTUARËT				
1.1	PUNËT PARAPRAKE				
1.1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i instalimeve në punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	707	0.50	353.50
1.1.2	Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m'	707	0.50	353.50
1.1.3	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve.	m'	707	0.50	353.50
1.1.4	Prerja dhe demolimi i dy shtresave të asfaltit në hyrje dhe daljen e sheshit, si dhe transporti i tijë deri në deponim të cilën cilën e cakton organi mbikqyrës, jo më largë se 5 km.	m ²	250	1.00	250.00
1.1.5	Demontimi i kubzave egzistuese me shtresat zhavorike në tërë sipërfaqen e rrugës dhe trotuareve të sheshit, si dhe transporti i tyre deri në deponim të cilën cilën e cakton organi mbikqyrës, jo më largë se 5 km.	m ²	2,660.00	0.50	1,330.00
1.1.6	Demontimi i skajorve egzistuese përgjatë rrugës dhe trotuareve të sheshit, si dhe transporti i tyre deri në deponim të cilën cilën e cakton organi mbikqyrës, jo më largë se 5 km.	m'	1,100.00	0.50	550.00
GJITHSEJ :					3,190.50
1.2	PUNIMET E DHEUT				
1.2.1	Gërmimi i humusit t=20 cm, me ngarkim dhe bartje deri në deponim jashte trupit te rruges	m ³	764	1.00	764.00
1.2.2	Gërmimi i dheut të kategorisë së (III-IV) me makeneri, me ngarkim dhe bartje deri në deponi (deri në 5Km), duke llogaritur edhe kanalet ansore. Sasia të llogaritet në m ³ .	m ³	1,477.00	0.80	1,181.60
1.2.4	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmeri $Mv \geq 45 \text{ MN/m}^2$.	m ²	2,210.00	0.20	442.00
1.2.5	Punimi i bankinave me trashësi t=25cm dhe gjerësi 0.50m me materiali zhavorik frak.(0-32)mm.	m ³	85	8.00	680.00



		GJITHSEJ :			3,067.60
1.3	MBISTRUKTURA				
1.3.1	Furnizimi, punimi i shtreses stabilizuese me material jokohorent të granular (80MN/m ²) të trupit të rrugës 0-100mm me trashesi t=30cm me CBR>15%	m ³	798	0.50	399.00
1.3.2	Furnizimi, bartja dhe shtrirja e gjeotekstilit tipi TYPAR SF 49 nën shirita qarkullues(300gr/m ²)	m ²	2,660.00	0.80	2,128.00
	Furnizimi, bartja dhe shtrirja e zhavorit te lumit t=5cm për mbrojtjen e gjeotekstilit.	m ²	133	5.00	665.00
1.3.2	Furnizimi, punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=25cm dhe ngjeshja me cilindër sipas stanadarteve dhe rregullave teknike.	m ³	665	4.00	2,660.00
1.3.3	Furnizimi dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=15cm dhe ngjeshja me cilindër sipas stanadarteve dhe rregullave teknike	m ³	399	5.00	1,995.00
1.3.5	Furnizimi me material anesore te gurit me dimensione 15x25x50cm të vendosur në shtresen e betonit ne trashesi 15cm, për kufizimin e trotuarëve, ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimit EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i ansoreve te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rrugeve kaluese ekzistuese . Per te qene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga llaqi i qimentos. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori.	m'	550	10.00	5,500.00
1.3.6	Furnizimi me material anesore te gurit me dimensione 10x20x50cm të vendosur në shtresen e betonit ne trashesi 15cm, për kufizimin e trotuarëve, ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimit EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i ansoreve te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rrugeve kaluese ekzistuese . Per te qene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga llaqi i qimentos. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori.	m'	550	10.00	5,500.00



1.3.8	Furnizimi me material pllaka te gurit me siperfaqe te gravuar (gerrvishja e siperfaqes duhet te perputhet me planet inxhinierike dhe mostren e punuar) me dimensione 30x20x10cm ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimi EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i pllakave te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rrugeve kaluese ekzistuese . Per te qene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga (50-80) mm me zhavor adekuat. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori, ku do te perdoren 2 nuanca. Guret duhet te vendosen në shtrese betoni të klasit C-25/30, me trashsi t=15cm te armuar me rrjete Ø 8 mm 15 x 15 cm.	m ²	2,310.00	54.00	124,740.00
1.3.9	Furnizimi me material pllaka te gurit te ngritur tek siperfaqet e rrethit me siperfaqe te gravuar (gerrvishja e siperfaqes duhet te perputhet me planet inxhinierike dhe mostren e punuar) me dimensione 30x20x10cm ne vlera referuese te Standardit Evropiane EN 1341 'Pllaka e gurë natyror për dysheme ne hapësira të jashtme' me metoda te testimi EN 12407, EN 13755, EN 1926, EN 14157, EN 12371, EN 12372, EN 13161, EN 14066, EN 1936, EN 14231. Montimi i pllakave te gurit eshte parapare te behet ne pjeset e rrugeve kaluese ekzistuese . Per te qene I kualifikuar dhe i pranuar si material guri duhet te plotesoje Standardin EC (Deklaration of Conformity). Fugimi i gureve te behet nga (50-80) mm me zhavor adekuat. Ngjyra e gurit te caktohet nga Investitori, ku do te perdoren 2 nuanca. Guret duhet te vendosen në shtrese betoni të klasit C-25/30, me trashsi t=15cm te armuar me rrjete Ø 8 mm 15 x 15 cm.(Ky pzion do te realizohet ne siperfaqet hyrese tek rrethi per ngadalesim te shpejtesise-police i shtrese)	m ²	350	55.00	19,250.00
1.3.9	Ngritja dhe nivelizimi i pusetave të kanalizimit ekzistues deri në nivelin e gureve si dhe furnizimi me kapak kompozit 40t dhe montimi i tyre në bazament betoni.	copë	13	85.00	1,105.00
1.3.10	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtes nga materialet ndertimore.	m'	390	1.00	390.00
GJITHSEJ :					164,332.00
1.4	PUNËT E BETONIT				
1.4.1	Punët montuese				



4.1.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave betonarne Ø400mm me mufa për leshesën gypore si ne projekt duke llogaritur edhe betonin e kokave hyrse dhe dalje, përfshir edhe punët e gërmimit, zhavorit, me të gjitha pozicionet e nevojshme për ekzekutim të punimeve.	m'	4	50.00	200.00
GJITHSEJ :					200.00
1	RRUGA DHE TROTUARET				
1.1	PUNËT PARAPRAKE			Gjithsej 1.1:	3,190.50
1.2	PUNIMET E DHEUT			Gjithsej 1.2:	3,067.60
1.3	MBISTRUKTURA			Gjithsej 1.3:	164,332.00
1.4	PUNËT E BETONIT			Gjithsej 1.4:	200.00
GJITHSEJ					170,790.10
2	NDËRTIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK				
2.1	Punët përgaditore				
2.1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i përkohshëm i tyre	m'	395	0.20	79.00
2.1.2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rjeti i kanalizimit atmosferik si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik	m'	395	1.00	395.00
Subtotali :					474.00
2.2	Punët Demoluese				
2.2.1	Demolimi i gypave të Kanalizimit ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demouar në deponinë legale ose në vendin te cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	m'	395	1.00	395.00
Subtotali :					395.00
2.3	Punët tokësore				
2.3.1	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe kolektorët e grilave në kat. III-IV të dheut, më makinë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellsi sipas profilit gjatësor.	m³	479	1.00	479.00
2.3.2	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe kolektorët e grilave në kat. III-IV të dheut, më dorë, në zgjerimet për puseta si dhe vendet ku nuk mund të punohet më makinë. Gjërësia e kanalit sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellsi sipas profilit gjatësor.	m³	47.9	1.00	47.90




2.3.3	Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, sipas detalit në projekt, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet për thellësit dhe kategorinë e tokës që janë të parapara më masat e mbrojtjes në punë. Sasitë janë indikative dhe punëkryesi në bashkpunim më organin mbikqyrës vendos se ku do të aplikohen këto masa. Rrjedhimisht të dy mbajnë përgjegjësinë për këtë proces	m ²	290	1.00	290.00
2.3.4	Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m ²	300	0.30	90.00
2.3.5	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar (tepërt) deri në deponi të qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi maksimale deri në 10km.	m ³	526.9	0.50	263.45
2.3.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rërës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa	m ³	139.2	5.00	696.00
2.3.7	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 16-31.5 mm për mbushjen e kanalit nga pjesa e sipërme e gypit deri në nivelin e konstruksionit të rrugës. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m ³	286	5.00	1,430.00
2.3.8	Largimi i ujërave nëntokësore me pompa. Ky pozicion është indikativ dhe është paraparë për rastin e paraqiten se ujit në kanal gjatë egzekutimit.	orë	10	5.00	50.00
Subtotali:					3,346.35
2.4	Punët montuese				
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar HDPE SN4 për kolektorin kryesor.				
2.4.1	Ø315	m'	210	7.00	1,470.00
2.4.2	Ø250	m'	80	4.00	320.00
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN4 për kolektorët e grilave për ujmbledhsat.				
2.4.3	PESN8 Ø 200 mm	m'	56	4.00	224.00
Subtotali:					2,014.00
2.5	Punët e betonit dhe armaturës				
2.5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta, me betonarme C-20/25 d=20cm	m ³	4.5	65.00	292.50
2.5.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit me betonarme C-20/25.	m ³	3.2	65.00	208.00
2.5.3	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuara).	copë	10	50.00	500.00
2.5.4	Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuara).	copë	10	30.00	300.00




2.5.5	Furnizimi transporti dhe montimi i tubave prej betonit të armuar Ø400/1000mm për pusetat e ujëbledhësve.(elemente të parafabrikuara).	copë	10	30.00	300.00
2.5.6	Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorrozive.	copë	56	5.00	280.00
2.5.7	Furnizimi, transporti, montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, më aftesi mbajtëse 40t. Në çmim të llogaritit edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-20/25.	copë	8	100.00	800.00
2.5.8	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësa (prej gize), Në çmim të llogarohet betoni i kurorës sipas detalit të dhëne prej beton armesë C-20/25.	copë	8	85.00	680.00
Subtotali:					3,360.50
2.6	Punët tjera				
2.6.1	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtes	m	290	0.20	58.00
2.6.2	Testimi i rrjetës së kanalizimit atmosferik.	m'	290	0.20	58.00
2.6.3	Matjet gjeodezike dhe përpilimi i dokumentacionit teknik të punëve për punët e zbatuara si dhe dorëzimi teknik i projektit	m'	290	0.20	58.00
Subtotali:					174.00
GJITHSEJ KANALIZIMI ATMOSFERIK, Gjithsej :					9,763.85
3	KANALI REZERVË				
	Përshkrimi i punimeve dhe i materialit për furnizim	Njësia	Sasia		
3.1	Hapja e kanalit me dim. 60x180cm, për shtrirjen e gypave PE të brinjëzuar, ngjeshja, mbulimi i kanalit pas shtrirjes së gypave dhe rërës si dhe largimi i dheut të tepërt	m ³	421.2	0.80	336.96
3.2	Hapja e pusetës me dimensione 200x200x200cm dhe largimi i dheut të tepërt	m ³	112.5	0.80	90.00
3.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e rërës së imët me trashësi 20cm nën dhe mbi gypat PVC	m ³	140.4	5.00	702.00
3.4	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave PE të brinjëzuar SN4, Ø160mm (4x Ø160mm)	m	1,560.00	3.00	4,680.00
3.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e mbrojtëses mekanike të kablllove tip GAL, dhe i shiritit paralajmërues "RREZIK TENSIONI" përgjatë gjatësisë së kanalit	m'	390	0.50	195.00
3.6	Furnizimi, transporti dhe shenjëzimi i pusetave me shenja të mesingut për tension	Copë	15	5.00	75.00
3.7	Furnizimi, transporti dhe punimi i pusetës me dimensione 200x200x200cm, nga betoni i armuar i lyer me material hidroizolues, kapaku i së cilës është metalik me formë katrore prej materialit të derdhur me dimensione 65x65cm, që do të jetë për nevoja të shpërndarjes së kablllove të tensionit të lartë, dhe kablllove të ndryshme.	Copë	16	200.00	3,200.00



Gjithsej Kanali rezervë:					9,278.96
4	NDRIQIMI PUBLIK				
	Përshkrimi i punimeve dhe i materialit për furnizim	Njësia	Sasia		
4.1	Mihja dhe mbulimi I kanalit per shtrirjen e gypit dhe kabllit furnizus per ndriqim 800x40cm (800m).	m ³	124.8	1.00	124.80
4.2	Mihja e dheut per bazament te shtyllave me dimensione 70x70x80 cm	copë	18	1.00	18.00
4.3	Furnizimi transporti dhe vendosja e shiritit per tokezimFe/Zn 25x4 mm.	m	390	1.00	390.00
4.4	Furnizimi transporti betonimi i bazamentit të shtyllave 70x70x80 cm me beton të tipit MB30, si dhe vendosja e gypi HDPE SN8Ø200mm për ankerim të trupit ndriques.	copë	18	35.00	630.00
4.5	Porosia dhe vendosja e gypit te brinjezuar PVC Ø63 për kabllon furnizuese te trupave.	m	390	1.00	390.00
4.6	Furnizimi transporti vendosja e shiritit mbrojtës të tipit GAL.	m	390	1.00	390.00
4.7	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues .	m	390	0.50	195.00
4.8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rrerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gyp.	m ³	62.4	5.00	312.00
4.9	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 16-32 mm për mbushjen e kanalit nga pjesa e sipërme e gypit deri ne nivelin e konstruksionit të trotuarit. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, DPr 103%	m ³	62.4	5.00	312.00
4.1	Furnizimi transporti dhe montimi i njehsorit elektrik te tipit 3x380/220V,5A,50Hz.	copë	1	10.00	10.00
4.11	Furnizimi transporti dhe montimi I Ormanit shpërndarës me dimensione 1000x950x400 mm IP 40 i kompletuar.	copë	1	300.00	300.00
4.12	Furnizimi transporti dhe montimi shtyllave metalike dekorative të galvanizuara te ndriqimit, me lartesi 8.0m, me dere per hapje, formë konike me lira një krihshe dhe trashesi te mureve dhe pamje te dhene si ne pjesen grafike. Modeli i shtyllave dekorative eshte paraqitur ne pjeswn grafike te projektit, ose ne konsultim me organin mbikqyres percaktohet modeli i shtylles.	copë	18	150.00	2,700.00
4.13	Furnizimi transporti dhe montimi shtyllave metalike dekorative me lartesi 8.0m të galvanizuara, që do te vendosen në dy rrethrotullimet, me dere per hapje, formë konike me lira katër krihshe dhe trashesi te mureve dhe pamje te dhene si ne pjesen grafike. Modeli i shtyllave dekorative eshte paraqitur ne pjeswn grafike te projektit, ose ne konsultim me organin mbikqyres percaktohet modeli i shtylles.	copë	1	150.00	150.00



4.14	<p>Furnizimi dhe montimi i armaturave ndriçuese të teknologjisë LED. Ndriçuesi LED duhet të përmbajë këto karakteristika:</p> <p>1 LED ndriçues me shpërndarje asimetrike të dritës me drajver të programuar, me mundësi të zvogëlimit të intensitetit të dritës deri në 50%</p> <p>2 Mbajtja e fluksit të dritës minimalisht L80B10 të 50000 orë pune</p> <p>3 Rezistenca ndaj goditjeve IK10 sipas HRN EN 62262</p> <p>4 Efikasiteti i ndriçuesit >122 lm/W</p> <p>5 ULOR=0%</p> <p>6 Mbrojtja e tërë ndriçuesit në IP66 sipas EN 60598</p> <p>7 Garancioni pesë vjeçar i prodhuesit për tërë ndriçuesin që duhet të vëtetohet me dokumentacionin përkatës</p> <p>8 Faktori CRI>80; 4000K</p> <p>9 Fuqia e ndriçuesit 98ë-118ë dhe me fluks të dritës prej 11 956 lm deri në 14396lm</p> <p>10 Trupi i ndriçuesit duhet të jetë nga alumini</p> <p>11 LED ÇIPI: Cree, XTE</p> <p>12 Numri i LED moduleve: 5-6</p> <p>13 Numri i çipave (qelulave) për modul: 12 copë</p> <p>14 Ndriçuesi duhet të jetë i çertifikuar nga: CE, ENEC, IIDA dhe ISO (ISO 9001:2008 dhe ISO 14001:2004)</p> <p>Armaturat ndiçuese LED duhet të jenë të prodhuara kualitetiv.</p>	copë	22	85.00	1,870.00
4.15	Furnizimi transporti dhe montimi bazes së araditit për lidhje dhe vazhdim të kablos furnizuese të ndriçimit NYM 3x1.5 mm ² , për shtyllë.	copë	18	10.00	180.00
4.16	Furnizimi transporti dhe montimi i kablos për furnizim të poqit ndriçues nga baza e araditit PPY 3X1.5 mm ² .	m	390	1.00	390.00
4.17	Furnizimi transporti dhe vendosja e kablos furnizuese të tipit NYJ-J(Cu) 4x25mm ²	m	50	5.00	250.00
4.18	Furnizimi transporti montimi I ndërprerësve AS-160A Shneider.	copë	1	50.00	50.00
4.19	Furnizimi transporti montimi I ndërprerësve gungor 100A Shneider.	copë	1	25.00	25.00
4.2	Furnizimi transporti dhe montimi i transformatorit rrymor 100/5A.	copë	1	25.00	25.00
4.21	Furnizimi transporti montimi I mikrnderprerës 6A.	cope	1	25.00	25.00
4.22	Furnizimi transporti montimi I portllampë me bazë E27.	copë	1	25.00	25.00
4.23	Furnizimi transporti montimi I prizës OG 10A.	copë	1	5.00	5.00
4.24	Furnizimi transporti montimi I pajisjet për matje-Votmetër 0-500V.	copë	1	5.00	5.00
4.25	Furnizimi transporti montimi I ndërprerës të tipit GS 16-66U.	copë	1	5.00	5.00
4.26	Furnizimi transporti montimi I siguresa trepolare gjysmeautomatike 63A.	cope	4	5.00	20.00



4.27	Furnizimi transporti montimi I sigureses njepolare 10A.	copë	3	5.00	15.00
4.28	Furnizimi transporti montimi I instrument për matje-Ampermetër 0-200A.	copë	1	5.00	5.00
4.29	Furnizimi transporti montimi I nderpreresit zgjedhes per ampermeter 80A-ti-R10	copë	1	5.00	5.00
4.3	Furnizimi transporti montimi I përçuesit PF 1x25mm².	m	70	1.00	70.00
4.31	Furnizimi transporti montimi I përçuesit PF 1x2,5mm².	m	70	1.00	70.00
4.32	Furnizimi transporti montimi I i kontaktorëve të tipit CS 100-160A.	copë	1	10.00	10.00
4.33	Furnizimi transporti montimi I i fotorelesë .	copë	1	10.00	10.00
4.34	Porositja dhe realizimi I atesteteve te tokezimit dhe te izolimit te kablllove	copë	1	10.00	10.00
4.35	Furnizimi transporti dhe shenjezimi i trases me shenja	copë	14	10.00	140.00
4.36	Realizimi I inqizimit te terenit	m	390	0.20	78.00
4.37	Pastrimi i terenit	m	390	0.20	78.00
Gjithsejt 4:					9,287.80
1	RRUGA DHE TROTUARËT				170,790.10
2	NDËRTIMI I KANALIZIMIT ATMOSFERIK				9,763.85
3	KANALI REZERVË				9,278.96
4	NDRIQIMI PUBLIK				9,287.80
Shumën totale duke aplikuar të gjitha taksat dhe tarifat					199,120.71
identifikimi i operatorit ekonomik					
EMRI I OPERATORIT	Nbt-ing shpk				
Adresa	suhareke				
paraqet					
EMRI & MBIEMRI	tahir sofa				
POZITA	drejtor				
NËNSHKRIMI					
DATA	02.09.2019				
VULA	